


Gusht 2025

BULETINI INFORMATIV

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

TRAJNIMI ME TEMË: “ZHVILLIMI I SISTEMIT TË NDIHMËS JURIDIKE FALAS NË SHQIPËRI NË PERSPEKTIVËN E STANDARTEVE TË BASHKIMIT EVROPIAN”



Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike ka zhvilluar trajnimin e detyrueshëm të punonjësve të Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore. Ky trajnim shënon edhe përmbyshjen e një prej prioriteteve të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas për periudhën Qershor - Gusht 2025.

QENDRAT E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

Përfaqësuesja e përhershme e **UNDP** në Shqipëri znj. Randi Davis vizitoi ambientet e **Qshnjp Gjirokastrë** ku diskutoi mbi shërbimet e ofruara pranë kësaj qendre.



Qshnjp Vlorë në datën 25.08.2025 në Ditën Ndërkombëtare të Përkujtimit të Viktimave të Dhunës bazuar në fe ose besim, zhvilluan një takim me përfaqësues nga komunitetet fetare që bashkëjetojnë në qytetin e Vlorës. Në takim u diskutua rëndësia e promovimit të tolerancës fetare dhe forcimit të bashkëpunimit mes komuniteteve fetare për të parandaluar dhe adresuar dhunën ndaj individëve për shkak të fesë apo bindjeve të tyre.

Qshnjp Shkodër, në kuadër të bashkëpunimit me Shërbimet Sociale të Bashkisë Shkodër, zhvilluan një takim për të ofruar mbështetje dhe këshillim ligjor për familjet e komunitetit Rom dhe Egjiptian të cilat janë prekur nga projekti “Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës”.




Qshnjp Përmet dhe Qshnjp Gjirokastrë në kuadër të përpjekjeve për të garantuar qasje të barabartë në drejtësi, zhvilluan një takim pranë banorëve nga komuniteti Rom, me synim informimin dhe ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e ndihmës juridike falas.

Qshnjp Gjirokastrë dhe Qshnjp Përmet, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Përkujtimit të Viktimave të Dhunës bazuar në fe ose besim, zhvilluan një aktivitet informues “Street Law”.



Në datën 11.08.2025 **Qshnjp Gjirokastrë** ishte pjesë e aktivitetit të zhvilluar nga Avokati i Popullit me temë: Diskutime për të drejtat kryesore të pakicave kombëtare në respektim të Ligjit Nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë. Barazia dhe mosdiskriminimi”.



Në datën 22.08.2025 **Qshnjp Kurbin** zhvilloi një sesion informues “Street Law”, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Përkujtimit të Viktimave të Dhunës bazuar në fe ose besim.

Qshnjp Korçë në datën 13.08.2025 realizoi një takim informues në Njësinë Administrative Voskopojë ku qytetarët u njohën me Ligjin Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.



Qshnjp Korçë në datën 19.08.2025 realizoi një takim me përfaqësuesin e organizatës “Misioni Emanuel” në qytetin e Korçës z. Ervin Dallaku ku u diskutua mbi autorizimin dhe financimin e organizatave jo fitimprurëse në dhënien e ndihmës juridike parësore.

Qshnjp Korçë në datën 22.08.2025, në Ditën Ndërkombëtare të Përkujtimit të Viktimave të Dhunës bazuar në fe ose besim, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kujdesit Social realizuan një takim informues me qytetarët mbi ndihmën juridike falas.



Qshnjp Tropojë, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Përkujtimit të Viktimave të Dhunës bazuar në fe ose besim, realizoi një sesion informues “Street Law” mbi Ligjin Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Qshnjp Fier ishte pjesë e një takimi të zhvilluar pranë Bashkisë Fier me temë: “Fuqizimi i Strukturave Lokale dhe Institucioneve Qeveritare për të parandaluar Ekstremizmin e Dhunshëm dhe për të mbështetur procesin e Rehabilitimit dhe Ri-integrimit në Shqipëri”



Qshnjp Elbasan zhvilloi në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Përkujtimit të Viktimave të Dhunës bazuar në fe ose besim, zhvilloi një seri takimesh informuese me qytetarë të Elbasanit.

Qshnjp Elbasan zhvilloi një aktivitet informues “Street Law” mbi Ligjin Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.



Qshnjp Dibër në datën 18.08.2025 zhvilloi një takim me përfaqësues të Organizatës Jofitimprurëse “Argitra Vizion”. Në takim u diskutua mbi kategoritë e veçanta përfituese të Ndihmës Juridike Falas dhe mundësinë e referimit të rasteve.

Qshnjp Mat në datën 01.08.2025 mori pjesë në takimin e zhvilluar nga Grupi Teknik Ndërsektorial, pranë Drejtorisë së Shërbimit Social, Mat. Në takim u diskutua mbi referimin e rasteve të dhunës në familje.

